

Nr. _____ Prot.
_____. _____.2018

Tiranë më,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 09.08.2018]

Për: **Shoqërinë "R & T" Shpk,**
Adresë: Tiranë, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shk.A, Kati 10.

Procedura e prokurimit: **"Procedure e Hapur"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-66977-05-03-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Ndërtimi i depos qendrore të re të barnave ne QSUT"**, me fond limit total prej: **225,280,810** (dyqind e njëzet e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH** dhe **270 336 972** (dyqind e shtatëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë me TVSH** (finacim i ndarë): Per vitin 2018 = 45,000,000 (dyzet e pesë milion) **lekë pa TVSH** dhe **54 000 000** (pesëdhjetë e katër milion) **lekë me TVSH**, Per vitin 2019 e ne vazhdim = 180,280,810 (njëqind e tetëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH** dhe **216,336,972** (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë me TVSH**.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **13 (trembedhjete) muaj nga hyrja në fuqi e kontrates**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Dt.07.05.2018] [Nr.18]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "COMFORT" Shpk **J61901194M**

Vlera: 0 (zero) leke

2. "R&T" Shpk **J61901094G**

Vlera: 140,000,000.00 (njëqind e dyzet milion) lekë pa TVSH

3. BOE “MELA. dhe CURI dhe ALBSPRESA” Shpk, përfaqësuar nga OE “MELA.” Shpk me NIUS K62320011G

Vlera: 146,000,000.00 (njëqind e dyzet e gjashtë milion) lekë pa TVSH

4. BOE “Ante-Group dhe GJIKURIA” Shpk, përfaqësuar nga OE “Ante-Group” Shpk me NIUS J62904100D

Vlera: 157,712,358.00 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

5. “JUNIK” Shpk

J68007522L

Vlera: 161,626,231.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH

6. “4 A-M” Shpk

K92005016L

Vlera: 164,224,505.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e pesë) lekë pa TVSH

7. BOE “EURO-ALB dhe VIANTE KONSTRUKSION dhe ERGI” Shpk, përfaqësuar nga OE “EURO-ALB” Shpk me NIUS K66613407H

Vlera: 164,384,789.19 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë.19) lekë pa TVSH

8. “2T” Shpk

K01731001M

Vlera: 169,403,708.06 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e tre mijë e shtatëqind e tetë.06) lekë pa TVSH

9. BOE “NDREGJONI dhe SENKA” Shpk, përfaqësuar nga OE “NDREGJONI” Shpk me NIUS K31329048I

Vlera: 176,239,197.00 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

10. BOE “EVEREST dhe AURORA KONSTRUKSION dhe BE – IS” Shpk, përfaqësuar nga OE “AURORA KONSTRUKSION” shpk me NIUS K02017003I

Vlera: 178,629,836.00 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

11. BOE “HASTOÇI dhe LEON KONSTRUKSION” Shpk, përfaqësuar nga OE “HASTOÇI” Shpk me NIUS J62028009B

Vlera: 180,735,572.00 (njëqind e tetëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

12. BOE “SHPRESA dhe SALILLARI” Shpk, përfaqësuar nga OE “SHPRESA” Shpk, me NUIS K67917301H

Vlera: 183,966,881.15 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një.15) lekë pa TVSH

13. BOE “RIVIERA 2008 dhe AGRI CONSTRUCTION” Shpk, përfaqësuar nga OE “AGRI CONSTRUCTION” Shpk, me NUIS K01725001F

Vlera: 185,000,843.56 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e tetëqind e dyzet e tre.56) lekë pa TVSH

14. “NDERTIM MONTIM PATOS” Shpk J63229454K

Vlera: 198,891,444.00 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “COMFORT” Shpk J61901194M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të cilin mund të bëhet vlerësimi apo kualifikimi për këtë procedurë prokurimi.

2. “JUNIK” Shpk J68007522L

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bazuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar), Neni 66, Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave, pika 4:

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmyjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër dhe referuar Ofertës ekonomike të OE, ka rezultuar se Oferta ka patur gabime aritmetike me vlerë më pak se 2% e vlerës së Ofertës, dhe për këtë OE i është kërkuar të bëjë korrigjimet përkatëse deri në dt.12.07.2018 (e Enjte), ora 15:30. OE nuk ka dorëzuar dhe pranuar Ofertën e korrigjuar brenda afatit të caktuar nga KVO.

OE ka dorëzuar dokumentacionin për inxhinierin elektronik z. Damian Laska; jo sipas DST, Shtojca 12, pika 2.3/h ku kërkohet:

.....te figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit Tetor 2017- Mars 2018.

Z. Damian Laska figuron vetëm në listepagesën e muajit Mars 2018.

3. BOE “RIVIERA 2008 dhe AGRI CONSTRUCTION” Shpk, përfaqësuar nga OE “AGRI CONSTRUCTION” Shpk me NIUS K01725001F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bazuar VKM Nr. 914, dt. 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar), Neni 66, Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave, pika 4:

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër dhe referuar Ofertës ekonomike të OE, rezulton se oferta ka gabime aritmetike në mbledhjen e vlerave për çdo zë, në seksionin “Preventiv Instalimet Paisje Elektrike”, perkatesisht:

Vlera totale e seksionit Pajisje Elektrike + Sistemi i ndricimit pajisjet /furnizim =11,058,000.00 lekë.

OE ka dorëzuar Oferten Ekonomike me vlerën totale Pajisje Elektrike + Sistemi i ndricimit pajisjet/furnizim =3,558,500.00 lekë.

Për sa më sipër, diferenca nga gabimi aritmetik është në vlerën 7,499,500.00 lekë, pra më e lartë se 2% e Ofertes se OE ($2\% * 185,000,843.56 = 37,000,168.71$ lekë); për pasojë, sipas LPP në fuqi, duke qënë se shumata absolute e korrigjimit është më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, kjo oferte ekonomike refuzohet.

4. “NDERTIM MONTIM PATOS” Shpk

J63229454K

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ka dorëzuar listë pagesat në formatin E-SIG 025/a të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas kërkesës në DST Shtojca 12, 2.3 pika c). OE ka dorëzuar vërtetimin "Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a" me nr. T00337808 dhe dt.04.06.2018, që nuk përputhet me kontributet e deklaruara në listë pagesat e dorëzuara dhe të pa miratuara nga organet përkatëse. Theksojmë se listë pagesat e konfirmuara nevojiten për të verifikuar prezencën e stafit teknik të kërkuara në DST, si kusht për vlerësim dhe kualifikim.

OE ka dorëzuar certifikatën ISO 3834-2:2005 në gjuhë të huaj, të pa përkthyer dhe noterizuar, jo sipas kërkesës në DST Shtojca 12, pika 2.4 f).

OE nuk ka dorëzuar kopje të bilancit për vitin 2015,2016,2017, sipas kërkesave në DST, pika 2.2, a).

OE nuk ka dorëzuar deklaratën për përmbushjen e Kriterëve të përgjithshme për pranim/kualifikim, sipas DST, Shtojca 12, pika 1.

OE nuk ka dorëzuar licencën për Mbrojtjen nga zjarri me kodin 1.2.A., sipas kërkesës të bërë në DST, Shtojca 12, pika 2.3 i).

OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin për stafin teknik të kërkuar sipas DST, Shtojca 12, pika 2.3; përkatësisht për Mjek, Drejtuesin Teknik, Inxhinier Ndërtimi profili strukturist, ing. gjeolog, ing. mjedisi, ing. topograf, eksperti i sigurisë teknike dhe shëndetit në punë, specialist të

certifikuar për punime në lartësi, ekspert zjarrfikës, ing. elektronik, teknik ndërtimi, 2 punonjës elektrikist, 2 punonjës mekanik, 3 punonjës me leje manovrimi (automakinist).

OE nuk ka dorëzuar deklaratë për pajisjet në dispozicion, sipas DST Shtojca 10, për: vibrator, skele 1500 m², minieskavator (bobcat), nivelues betoni, beton forma, rripa sigurimi, prozhektor nate, komplet i ndihmës së shpejtë, tabela për sigurinë në objekt.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqërinë “R & T” Shpk**, me adresë: Tiranë, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shk.A, Kati 10, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **140,000,000.00 (njëqind e dyzet milion) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë** me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 – Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. |

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **26.07.2018** dhe riklasifikimit në datë **01.08.2018**

Ankesa: Ka patur dhe ka marr përgjigje me datë 31.07.2018



NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR I DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE

Suela ZINA